

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 25/2 / Prot.

Tiranë, më 13/10/2021

VENDIM
Nr. 74, datë 13.10.2021

PËR
“ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të nenit 36, pika 3, nenit 38, pika 1, germa gj), nenit 47, nenit 48 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 26, pika 1, germa h), nenit 49 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 68, datë 15.09.2021 “Për miratimin e kriterëve ...”, të Vendimit të Komisionit *ad hoc* me nr. 2297/10 prot., datë 11.10.2021 “Vendim” si dhe me përfundimin e mandatis 5 (pesë) vjeçar, referuar Vendimit të Senatit Akademik nr. 85, datë 12.10.2016 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit...”, Senati Akademik, pasi realizoi procesin e votimit për anëtarët e Bordit të Administrimit, përfaqësues të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë dhe të shpallë fitues në cilësinë e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kandidatët si më poshtë:

Përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

- Monika Fida
- Vera Ostreni

Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

- Altina Xhaferri

2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bordit të Administrimit dhe njësisë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETARI
PROF. ARBEN GJATA

Web site: www.umec.edu.al